

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 07.10.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtimi i nënstacioni të ri Velipojë 110/35/20kV”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(FPP): 45232221-7 – Nënstacion transformator

VLERA E FONDIT LIMIT:

449,990,927.84 (katërqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë pikë tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Ndërtimi i nënstacioni të ri Velipojë 110/35/20kV” (OSSH sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prova për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të çertifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2021**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin,

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” I ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesinë e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kërkuara, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontratë të ngjashme, të jetë sipas parashikimeve ligjore. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Gjithashtu, duke patur në vëmendje punën e vështirë që duhet të bëjë OE në realizimin e kësaj kontrate, pasi duhet të ketë përvojën e nevojshme të bëjë punime në një shtyllë të tensionit të lartë në tension, AK kërkon me doemos që OE ofertues t’ia ketë një përvojë të ngjashme për ndërtimi nënstacionesh ose centrale elektrike.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

1. Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

1. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
6. Fatura tatimore përfundimtare.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

2.3.5 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për keto punime.

a) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të jete Ing. Elektrik dhe të

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

1. Librezë pune
2. Kontratë pune e vlefshme
3. Diplomë

Argumentim: Cdo subjekt për vetë natyrën dhe përgjegjësinë e punës duhet të angazhojë një person të specializuar për drejtimin dhe mbarevajtjen e punimeve në kantiër. Ky person përgjegjës duhet të jetë në rolin e drejtuesit teknik në kompani. Kjo vërtetohet nëpërmjet licencës së kompanisë dhe dokumentave të sipër përmendura.

2.3.6 Operatori ekonomik (në bazë të VKM 312 Dt.05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë në kantiër) duhet të ketë të pakten 5 (pese) punonjës të trajnuar dhe të pajisur me çertifikatë të punimeve në lartësi të leshuara nga shoqëri të licencuara nga ministria përkatëse, të cilat të jenë të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- i) çertifikatën e inxhinierit
- ii) çertifikatat e punonjësve për punimet në lartësi
- iii) licencën e shoqërisë e cila ka trajnuar punonjësit e operatorit ekonomik.
- iv) listpagesat E-Sig të punonjësve të sipërcituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin teknik të certifikuar për punime në lartësi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kërkon punonjës që kanë aftësitë fizike dhe teknike për të punuar në kushte të vështira pune, në shtylla tensioni të lartë dhe në lartësi nga toka.

Përsa i përket kërkesës për një inxhinier të trajnuar dhe të pajisur me çertifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë me rrisht të lartë, argumentohet se është i nevojshëm të qendroje në kantiër në punimeve për të ndjekur ecurinë e punës së punonjësve të OE ofertues dhe të jetë i gatshëm në rastin e paraqitjes së kushteve të rrezikshme që mund të ndodhin gjatë zbatimit të kontratës objekt prokurimi, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë:

- 9 (nëntë) elektrikist.
- 5 (pesë) punonjes të kenë kategorine, **e IV ose më e lartë** dhe pjesa tjetër të jenë të pajisur me IQT për elektrikist.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Korrik - Shtator 2022**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik - Shtator 2022**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

C) Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **20 punonjës** për 3 muajt e fundit duke marrë

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

si reference datën e hapjes së tenderit; të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është perlllogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të shtyllave objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Korrik - Shtator 2022**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik - Shtator 2022**.

Ç) *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë të pakten 2 (dy) inxhinier ndertimi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier elektrik, 2 (dy) inxhinier topograf/Gjeodet. Inxhinieret e mesipërme duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat përkatëse E-Sig për 3 (tre) muajt e fundit.*

- Ing. Gjeodet 2 (dy)
- Ing. Elektrik 1 (një)
- Ing. Ndertimi 2 (dy)
- Ing. Mekanik 1 (një)

Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten CV-të, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **Korrik - Shtator 2022**.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.
Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Për sa i takon inxhinierëve të ndërtimit të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët e ndërtimit janë ekspertët kryesor për projektimin dhe zbatimin duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.

- Për sa i takon inxhinierit elektrik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri elektrik do të ndjekin ecurinë e punimeve elektrike që nga projektimi deri në zbatimin e plotë të investimit.

-Për sa i takon inxhinierit gjeodet të kërkuar, është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të projektimit dhe zbatimit të kontratës duke bërë të mundur matjet dhe rëlevimet topografike dhe batimetrike të kësaj kontrate specifike.

Për sa i takon inxhinierit mekanik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanikesi montime dhe demontime të pajisjeve dhe konstruksioneve mekanike të investimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar me kontratë ose në listëpagese, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të VKM-se nr. 692, datë 13.12.2001, ndryshuar me VKM 742 datë 06.11.2003. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të ketë një mjek të kompanisë).

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Argumentim: Referuar ligjit Nr.10237 date 18.02.2010 per sigurine dhe shendetin ne pune neni 23 pika 1. Cdo kompani duhet te kete te punesuar ose me kontrate sherbimi nje mjek per ofrimin e sherbimit te mjekut te kompanise. Per arsye te organizimit dhe monitorimit te veprimtarise se sigurise dhe shendetit ne pune, kontrollin /inspektimin periodik per gjendjen e masave mbrojtese ne pune dhe zbatimin e rregullores se sigurise dhe shendetit ne pune nga te gjitha punonjesit.

Trajnime per punonjesit per dhenine e ndihmes se pare apo shmangien e reziqeve qe mund te ekzpozohen punonjesit.

Ndjeka dhe analizimi i te dhenave ne lidhje me aksidentet ne pune apo semundejet profesionale.

2.3.8 Per listen e meposhtme te mallrave:

- Transformatori i Fuqise
- Çelezi 110 kV
- Çelat TM
- Ndaresi TM
- TR Rryme
- TR Tensioni

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

1. Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe. Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Argumentim:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet IEC .Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisës OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë deshmi të testimeve (type test ose rutine test) zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi.

Shenim: Testet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që e gjithë lista e kërkuar përbehet nga pajisje të vecanta që perdoren në N/stacione elektrike, kërkohej nga prodhuesi që të deshmojë se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombëtare sipas standarteve IEC. Kriteri I kërkuar në lidhje me testet tip ose rutine të produkteve të kërkuara nga prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin. Gjithashtu katalogu duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Gjithashtu për të siguruar që pajisjet që do të furnizohen nga Operatori ekonomik, janë të prodhuara nga prodhues të njohur dhe të pranuar sipas standarteve ndërkombëtare IEC. Kriteri I kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose të punësuar me kontratë shërbimi të paktën 1 (Një) Inxhinier Elektrik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe komisionimin pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatoreve Kalimtare të Transformatorit), i cili do të realizojë këtë shërbim.

Për të provuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Kontrata e punës
- Diplomë, CV
- Librezat e punës

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Çertifikata perkatese e Inxhinierit Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatoreve Kalimtare te Transformatorit).

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Kërkesa per te patur ne staf teknik 1 inxhinier elektrik i certifikuar nga prodhues i monitorimit dhe diagnostikimit e defekteve qe paraqiten ne transformatoret e fuqise ne N/stacionet elektrike eshte kerkuar nga ana jone sipas natyres se punes e cila eshte me instalimin dhe komisionimin & konfigurimin e setit te monitorimit online te transformatoreve te fuqise BMT(Bushing Monitoring of Transformer) 110/35/20 kV. Eshte natyre pune e cile kerkon specialist te certifikuar dhe ne nivel te larte profesional per venien ne funksion te pajisjeve te monitorimit online BMT te transformatorit te ri qe do te furnizojne ne N/stacionin 110/35/20/ kV velipoje. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë I shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

2.3.10 Liçensa profesionale e shoqërise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Punime te pergjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Klasifikim A
----------------	-------------------------	--------------

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

<u>Kategoria NP-2</u>	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim C
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Klasifikim F
<u>Kategoria NS-14</u>	Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, etj.	Klasifikimi A
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike.	Klasifikimi A

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Liçencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" .

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
-----	---------------------	-------	---------

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

1.	Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 5 ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
2.	Vinc kulle 0.5 - 1 ton, teleskopik per h > 7 m	1 copë	Pronësi ose me qera
3.	Vinc jo me te vogel se 100 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
4.	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
5.	Kamion me kapacitet mbajtes 5 - 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
6.	Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
7.	Motosaldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera
8.	Betoniere minimumi 500 m3	1 cope	Pronësi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: çertifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikate transporti, certifikate e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) leje qarkullimi; certifikaten e kontrollit teknik; certifikate transporti siguracion mjeti (i vlefshëm);

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

2.3.13 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrëveshje kontraktuale me disponuesit e ketyre licencave, lëshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Projektues konstruktor
Projektues instalator

- Pika 3/a,b
- Pikat 4/a.c.f.j

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Projektues gjeodet	- Pikat 8/a,
Projektim impianteve te shpernd. en. elektrike	- Pika 10/d

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Referuar Termave të Referencës si dhe llojit të procedurës së prokurimit (*neni 39, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*), kategoritë e kërkuara janë në përputhje me të gjitha detyrimet specifike që projekt zbatimi duhet të përmbajë.

Lidhur me Kontratë me çelsa në dore percaktohet ne nenin 39 te Vendimit 285, date 19.05.2021;

Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” percakton:

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse,

b) me kontratë me çelësa në dorë:

- i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.**

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

- ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.**

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Njësia e prokurimit